



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Nr. _____ Prot.

Data ____ . ____ . 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:“Rehabilitimi stacioneve te autobuseve dhe i stacionit te taksive elektrike segmentit nga Shkolla e Marines deri tek Regina City”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Asfalt,cakell dhe rere bitumi 14213007,Makineri Asfalti 43312300-8,Asfalt 4411362-7,Punime shtrimi dhe asfaltimi 45233222-1

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi Limit : **5,833,333 (Pesemilion e teteqind e tridhjete e tremije e treqind e tridhjete e tre)Lekë Pa TVSH.**

Argumentim:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a)çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit te tregut, bazuar ne mesataren e cmimeve te marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Në përfundim të punës grupi u referua ne nenin 76 te VKM Nr 285, datë 19.05.2021, pika

a)çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave te punimeve bazuar në VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të

çmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre”, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës. Afati i realizimit të punimeve është 1 (nje) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1- Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme perfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur nëqë dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e ketij kriteri, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarres te mundshem ne procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 ”Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021 dhe për vitin 2022. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter eshte përcaktuar bazuar ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 per kriteret detyruese per skualifikim, si dhe Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet

2. 3 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë sa 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është sa vlera limit e kontratës që prokurohet. Neni 55, pika 4, germa a.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve te sipërpërmëndura e ben ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacion Perfundimtar
- Kolaudim Punimesh
- Formular Vleresimi

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MIE, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP – 1 A Punime gërmimi në tokë

NP- 4 A Rruge ,Autostrada,mbikalime, hekurudhe,tramvaj,metro,pista ,aeroportuale

NS-6 A Sinjalistike Rrugore jo ndricuese

Operatorët e huaj duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucionit përkates sic percaktohet në Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP – 1 A Punime gjurmimi në tokë. Konsiderohen gjurmimet, sistemit dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohej vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. Këto punime kryhen nën drejtimin teknik të një inxhinieri ndertimi.

NP- 4 A Per punime Rruge ,Autostrada,mbikalime, hekurudhe,tramvaj,metro,pista ,aeroportuale

NS-6 A Per punime Sinjalistike Rrugore jo ndricuese

Për punimet speciale të ndërtimit :

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë

-1 (Nje) ing.ndertimi

-1 (Nje) ing.topograf ose topograf i mesem

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, dhe Cv.

Drejtuësit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.

- **Topograf ose topograf i mesem** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, dhe matjeve në teren duke përdorur projektin .

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- 1 (Nje) Manovrator te paisur me Leje/deshmi perkatese (leje manovrimi) dhe kontratën individuale të punës.

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht 10 persona, përfshirë stafin teknik (drejtues) për periudhën janar - Mars 2023 Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rast se shpallet fitues, për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën janar-mars 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën janar mars 2023 , sipas formatit E-Sig 025/a.

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të

këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri është vendosur, bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zberthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 877 orë pune punëtori, për të cilat nevojiten 2 punonjës, si dhe 170 orë pune makineri për të cilat nevojiten 1 punonjës, ku përfshirë edhe stafin teknik nevojiten në total të paktën 5 punonjës.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certificate cilesie sipas standartit ISO 9001:2015, ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim,
- Certificate cilesie sipas standartit ISO 14001:2015, ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalentet duhet te jene te leshuara nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojnë keto certifikata ne perputhje me punimet qe ka marre persiper te kryeje. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë, standardet e menaxhimit të mjedisit dhe standardet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të vërtetojë/disponojë që ka të punësuar mesatarisht 10 persona, përfshirë stafin teknik (drejtues) për periudhën janar- mars 2023. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët

ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rast se shpallet fitues, për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën janar mars 2023.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën shtator-dhjetor , sipas formatit E-Sig 025/a.

1-Karpentier 1(nje)

2-Hekurkthyes 1(Nje)

3-Specialist Ndertimi 2 (dy)

4- Manovrator (pajisur me deshmi apo leje makinerish +kontrate individuale te punes)1 (Nje)

5- Punetore 2(dy)

6- Drejtues Kamioni 1 (Nje)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri është vendosur, bazuar në sasitë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej 877 orë pune punëtori, për të cilat nevojiten 2 punonjës, si dhe 170 orë pune makineri për të cilat nevojiten 1 punonjës, ku përfshirë edhe stafin teknik nevojiten në total të paktën 8 punonjës.

2.3.8 Per mjetet dhe makinerit qe duhet te disponoje

1- Te kete nje kamion veteshkarkues jo me pak se 18 ton

2- Rul

3- Greider

4- Asfalto shtruese

5- Per mjete duhet leja e qarkullimit ,certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni .Mjetet te jene ne pronesi dhe me qera .

NJËSIA E PROKURIMIT:

NJHDT